



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802283/5

Tiranë ___/___/2019

Lënda: *Rekomandohet kryerja e veprimeve për dorëzimin e detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor nr. 1441, datë 03.10.2014, të dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, ndryshuar me Vendimin nr.274, datë 31.01.2017, prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, në favor të gjyqfituesit A.B.*

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë

DIVJAKË

I nderuar z. Kryetar!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka në procesin e shqyrtimit prej datës 19.11.2019, çështjen e prezantuar prej shtetasit, gjyqfituesit A.B., për mospërmbushjen nga ana e Bashkisë, Divjakë, të detyrimit për pagimin e pagave, sikurse vendosur nga Gjykata Administrativ e Shkallës së Parë, Vlorë, me Vendimin nr. 1441 datë 03.10.2014, lënë në fuqi me ndryshime prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 274, datë 31.01.2017, ju justifikoheni në shkresën nr. 4076/1 prot, datë 12.12.2018, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, se, shkak për mosekzekutimin e detyrimit të vendosur është kryerja e rekursit kundër vendimeve të lartpërmendura si dhe kryerja e kërkesës për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë.

Qëndrimi i shprehur nga ana juaj për justifikimin e mosekzekutimit të detyrimit të vendosur nuk vjen në përputhje me parashikimet e kryera në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se :

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”,
si dhe nenet 451 dhe 451/a, të Kodit të Procedurës Civile, në të cilët midis të tjerave parashikohet se :

Neni 451

“Vendimi merr formë të prerë kur:

Vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.

Neni 451/a

Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera”.

Përkundër parashikimeve ligjore për zbatimin e detyrimit sikurse cituar në dispozitat ligjore të mësipërme, ju, z. Kryetar, nuk keni mundur ekzekutimin e vendimit gjyqësor në afatin prej gjashtë muajsh sikurse përcaktuar në dispozitivin e Vendimit nr. 1441 datë 03.10.2014, të dhënë nga Gjykata Administrativ e Shkallës së Parë, Vlorë, i ndryshuar.

Kryerja e rekursit apo kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor pranë Gjykatës së Lartë, nuk përbën shkak për pezullimin e ekzekutimit të detyrimit të vendosur në rrugë gjyqësore.

Konstatohet se, Gjykata e Lartë mbi bazë të kërkesës të ushtruar nga ana juaj për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, ka vendosur me Vendimin nr. 632, datë 16.01.2018, për :

“Mospranimin e kërkesës të paraqitur nga Bashkia, Divjakë, për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1441, datë 03.10.2014, të Gjykatës Administrativ të Shkallës së Parë, Vlorë, ndryshuar me Vendimin nr. 274, datë 31.01.2017, prej Gjykatës së Apelit, Tiranë”.

Po kështu, ju bëjmë me dije, se, neni 500 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se;

“Paraqitja e kërkesës për rishikim nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Por gjykata, me kërkesën e palës, mund të pezulloj ekzekutimin e vendimit, kur vlerëson se ka rrezik që mund të shkaktohet një dëm i madh e i pariparueshëm”.

Përpos situatës si më sipër bërë të ditur, Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Privat, ka pranuar qysh në muajin Prill 2017, kërkesën e palës kreditore për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv. Aktualisht, përmbartuesi gjyqësor privat, z. A.H., është duke kryer veprime përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të lartpërmendur në ngarkim të Bashkisë, Divjakë, në kushtet kur, ju, z. Kryetar, nuk keni kryer dhe nuk kryeni veprimet për përmbushjen e një detyrimi të ligjshëm.

Referuar akteve të administruara, konstatojmë se, me shkresën nr.4283 prot, datë 03.09.2018, përmbartuesi gjyqësor i çështjes, ka lajmëruar organin që ju përfaqësoni për detyrimin e vendosur, si dhe caktuar afatin ligjor prej 5 ditësh për dorëzim vullnetar të detyrimit në të holla. Bazuar në përcaktimet e kryera në Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”*, ju keni pasur dhe keni detyrimin e kryerjes së veprimeve sikurse përcaktuar në pikat 3, 4, 5, 7, 8, dhe 10/b për përmbushjen e detyrimit të vendosur nga gjykata.

Fakti është, se, Bashkia, Divjakë, nuk ka pranuar dhe nuk pranon detyrimin e vendosur, bazuar në pretendime të cilat nuk janë marrë në konsiderat, deri më sot, nga ana e gjykatës.

Ky qëndrim i mbajtur, z. Kryetar, është i dënueshëm në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të kryera në nenin 606 të K.Pr.C., në të cilin thuhet midis të tjerave se :

“Sanksionet për moskryerjen e veprimit nga debitorit.

Ndaj debitorit që refuzon, kryen në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri 50.000 lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit.

...

Ndaj personave të tjerë, që sipas urdhërit të ekzekutimit ose ligjit janë të detyruar të kryejnë veprime të caktuara, në rastet e përcaktuara në paragrafin e pare të këtij neni, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri 50.000 lekë”,

apo nenin 248 të Kodit Penal, të ndryshuar, se :

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbaruesi të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjelle atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridike, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë”.

Duke marrë shkas prej qëndrimit të mbajtur prej jush, z. Kryetar, përmbaruesi gjyqësor i çështjes, ka kërkuar Gjykatës Administrativ të Shkallës së Parë, Vlorë, me kërkesën nr. 4913 prot, datë 17.12.2018, penalizimin e personit tuaj, gjykim i cili vijon të kryhet.

Përkundër situatës ligjore të bërë të ditur, Bashkia, Divjakë, vijon mbajtjen e qëndrimit të mosnjohjes e kundërshtimit të vendimit, duke mos marrë parasysh pasojat që vijnë nga ky qëndrim. Qëndrimin e shprehur në :

- Shkresën Nr. 2887/1 prot, datë 13.09.2018 drejtuar Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat;
- Shkresën Nr. 2981/1 prot, datë 18.09.2018, drejtuar Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat, si dhe përmbaruesit gjyqësor të çështjes;
- Shkresën Nr. 2980/1 prot, datë 18.09.2018, drejtuar Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat, si dhe përmbaruesit gjyqësor të çështjes;
- Shkresën Nr. 142/1 prot, datë 15.01.2019, drejtuar përmbaruesit gjyqësor të çështjes;

e gjejmë në cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszekutimit të detyrimit në një afat të arsyeshëm, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar prej Kuvendit të Shqipërisë me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

Zhvillimi i veprimtarisë së Bashkisë, Divjakë, në çështjen objekt prezantimi, kuptohet se, nuk vjen në përputhje me parimin e ligjshmërisë, sikurse parashikuar në nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative, dhe i detyrueshme për zbatim referuar nenit 2 të këtij Kodi.

Mosrespektimi i së drejtës të ankuesit brenda afatit ligjor, nuk i shërben rritjes dhe përmirësimit të standarteve të shtetit ligjor, pasi ai ndikon në mosfinalizimin e procesit të dhënies së drejtësisë dhe sikundër kuptohet edhe nga ankesa e mësipërme, ul autoritetin e

institucionit dhe krijon premisa për humbjen e besimit ndaj dhënies së drejtësisë, duke cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve të mbrojtura nga Kushtetuta dhe Ligjet.

Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i këtij vendimi gjyqësor të formës së prerë konsiderohet si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës si dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtët e Njeriut. Ekzekutimi i tij përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësisë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Gjykata Kushtetuese konsideron se, autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutim e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimmarrjet e veta, lidhur me të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, ka theksuar se, shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë të gjatë. Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjet e saj ka pranuar se : *“...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe nenin 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”*.

Në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 1441 datë 03.10.2014, të dhënë prej Gjykatës Administrativ të Shkallës së Parë, Vlorë,, lënë në fuqi me ndryshime prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 274, datë 31.01.2017, nr. 540, datë 03.12.2007, qëndrimi i organit që ju përfaqësoni nuk duhet të cënoji marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni në fuqi.

Edhe pse është konsumuar afati ligjor prej 6-mujsh i vendosur nga gjykata, për ekzekutimin e detyrimit apo njoftimi prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor për zbatimin vullnetar të vendimit gjyqësor, ju ende nuk keni mundur ekzekutimin e tij.

Në këtë kuadër, do të vinim theksin në faktin, se, angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë po bëhen gjithnjë dhe më konkrete, sidomos në planin e të drejtave të njeriut, të zbatimit të akteve juridike ndërkombëtare dhe të integritimit evropian. Do të ishte cënim i rëndë i autoritetit të shtetit, nëse ankuesi do t'i drejtohej Gjykatës së Strasburgut kundër Shtetit Shqiptar, për një të drejtë të kësaj natyre, ndërkohë që Qeveria në programin e saj e ka konsideruar problem të mprehtë dhe është angazhuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, Parlamenti Evropian në miratimin e rezolutës për Shqipërinë datë 08.07.2010, kujton autoritetet në Shqipëri se një nga kushtet e integritimit në BE është

reforma në gjyqësor, përfshi zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për zbatimin pa vonesë të Vendimit Gjyqësor nr. 1441, datë 03.10.2014, të dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, ndryshuar me Vendimin nr.274, datë 31.01.2017, prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, në favor të gjyqfituesit A.B.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform parashikimit të kryer në nenin 19 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA (CANAJ)

Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka